

KËRKESË
Nr. 128/7, datë 13.4.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rehabilitimi i rrugës së ish-Repartit Ushtarak për në aeroportin e Rinasit’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Shoqëria Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraparak të llogaritur për pasuritë e llojit “arë”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 477 120 (katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT’”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Lloji i pasurisë	TOKË ARË			VLERA TOTALE LEK	Adresa	Shënime
								Sip. e shpr.	Çmimi (lek/m ²)	Vlera, lek			
1.	Skënder	Sinan	Kulli	1669	42/69	3150	Arë	1065	448	477120	477,120.00	Tiranë (Fushë-Prezë)	Konfirmuar ASHK Tiranë. Në favor BKT. K. Hip. 1925/1016, datë 6.12.2018.
								1065	448	477120	477,120.00		